

**RREGULLORE**  
**PER ANETARESIMIN E FARMACISTEVE,**  
**REGJISTRIMIN E NDIHMES FARMACISTEVE**  
**DHE**  
**FUNKSIONIMIN E REGJISTRIT KOMBETAR TE**  
**URDHRIT TE FARMACISTEVE TE SHQIPERISE.**

**Neni 1**

**Dispozita të Përgjithshme**

1. Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë mban Regjistrin Themeltar Kombëtar të anetarëve të tij, në formë elektronike dhe manuale. Këshilli Rajonal është i vetmi organ që pranon anëtarësimin në Urdhrin e Farmacistëve.
2. Aparati Qendror Ekzekutiv i Këshillit Kombëtar është autoriteti përgjegjës për mirëmbajtjen e Regjistrit Kombëtar, në mënyrë manuale dhe elektronike. Per këtë qëllim, pranë Aparatit Qendror Ekzekutiv të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë, funksionon sektori i anëtarësimit të farmacistëve dhe regjistrimit të ndihmës farmacistëve.

**Neni 2**

**Baza Ligjore**

Sektori i regjistrimit dhe çertifikimit të farmacistëve, e ushtron veprimtarinë e tij, në mbështetje të Ligjit Nr. 9150, datë 30.10.2003 “Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 4, 5 dhe 6. të Statutit të Urdhrit të Farmacistëve, si dhe të ligjit Nr. 9323, datë 25.11.2004 ”Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, ligjit Nr. 10171, dt 22.10.2009 ”Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”.

**Neni 3**

**Anëtarësimi dhe Regjistrimi**

1. Çdo farmacist ose ndihmës farmacist që kërkon të anëtarësohet ose regjistrohet në Urdhrin e Farmacistëve të Shqipërisë duhet të paraqitet personalisht në Këshillin Rajonal përkatës.
2. Këshilli Rajonal pranon anëtarësimin në Urdhrin e Farmacistëve vetëm kur i interesuari plotëson kushtet siç përcaktohen në nenin 9 të Statutit të Urdhrit të Farmacistëve.
3. Pas plotësimit të dokumentacionit sipas formularit përkatës ( formulari nr. 1 dhe formulari nr.2), presidenti ose sekretari i këshillit rajonal nënshkruan dhe vulos shkresën përcjellëse dhe e paraqet dosjen e plotë

pranë sektorit të anëtarësimit të farmacistëve dhe regjistrimit të ndihmës farmacistëve, pranë Aparatit Qendror Ekzekutiv të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë.

4. Dërgimi i dokumentacionit bëhet me postë ose me zarf të mbyllur me anë të vetë personit të interesuar për anëtarësim ose ndryshime.

#### **Neni 4**

#### **Vendimmarrja për anëtarësim dhe regjistrim**

1. Vendimmarrja për anëtarësim dhe regjistrim merret nga Komisioni i Regjistrimit dhe i Dhënies së të Drejtës së Ushtrimit të Profesionit i cili përbëhet nga kryetari, zv/ kryetari dhe sekretari, ku respektivisht janë përgjegjësi i anëtarësimit dhe regjistrimit, presidenti i këshillit rajonal dhe sekretari i këshillit rajonal përkatës.

2. Sektori i anëtarësimit të farmacistëve dhe regjistrimit të ndihmës farmacistëve refuzon anëtarësimin e çdo individi, kur bie në kundërshtim me nenin 9 të statutit të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë si dhe kur dokumentacioni për anëtarësim ose regjistrim nuk është i plotësuar në bazë të formularëve përkatës.

Ky refuzim bëhet deri në momentin e plotësimit të të gjithë këtyre kritereve.

3. Sektori i anëtarësimit të farmacistëve dhe regjistrimit të ndihmës farmacistëve, pasi konstaton vërtetësinë e dokumentacionit, nënshkruan në shkresën përcjellëse ( emë, mbiemër dhe firmë), plotëson certifikatën e re të anëtarësimit ose regjistrimit dhe bën dorëzimin e saj tek personi që e sjell ose e dërgon atë me postë në këshillin rajonal përkatës.

#### **Neni 5**

#### **Regjistrimi dhe Eksperienca e punës për farmacistët të cilët diplomohen jashtë vendit**

1. Farmacistët të cilët diplomohen jashtë Republikës së Shqipërisë dhe shtetasit e huaj duhet të konvertojnë diplomën e tyre në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës sipas legjislacionit në fuqi, bazuar kjo në neni 9 të Statutit.

2. Për ti ardhur në ndihmë këtyre farmacistëve, meqë procesi i ekuivalentimit kërkon një kohë të caktuar, në momentin e regjistrimit mjafton që krahas diplomës dhe listës së notave të përkthyer dhe noterizuar, të sjellin një vërtetim që marrin nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, që diploma e tyre është në proces ekuivalentimi. Ky vërtetim zëvendësohet me dokumentin e ekuivalentimit që lëshon Ministria e Arsimit dhe Shkencës, brenda kohës kur këtij vërtetimi i mbaron afati, në të kundërt farmacisti çrregjistrohet dhe lajmërohen organet përkatëse.

3. Farmacistët të cilët diplomohen, fitojnë të drejtën e ushtrimit të profesionit dhe punojnë jashtë vendit, nqs vendosin të kthehen në Shqipëri që të licensohen dhe të fillojnë veprimtarinë e tyre, dokumenti i barazvlefshëm me librezën e punës dhe të sigurimeve që kërkohet tek ne, do të jetë vërtetimi i marrë nga zyra e punës së vendit ku ato jetojnë, vërtetimi me data nga vendet e punës ku ato kanë punuar si dhe dokumenti i regjistrimit në Urdhrin e Farmacistëve në vendin ku ato kanë punuar.

4. Ndërsa shtetasit e huaj të cilët dëshirojnë të ushtrojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë, pas regjistrimit sipas kriterëve të nenit 9, pika 6 të statutit, duhet të paraqiten me leje pune dhe leje qëndrimi, nga autoritetet përkatëse të vendit tonë.

## **Neni 6**

### **Çertifikata e Anëtarësimit dhe Çertifikata e Regjistrimit**

Është dokumenti zyrtar i lëshuar nga Urdhri i Farmacistëve që vërteton anëtarësimin për të drejtën e ushtrimit të profesionit, në funksionin e përcaktuar të një veprimtarie farmaceutike.

Çertifikata e Anëtarësimit, për drejtues teknik dhe të punësuar, i jepet çdo farmacisti të rregjistruar në Urdhër.

Çertifikata e Rregjistrimit, për drejtues teknik dhe të punësuar, i jepet çdo ndihmës farmacisti të rregjistruar në rregjistrin e posaçëm të Urdhrit.

Çertifikata e Anëtarësimit dhe Çertifikata e Regjistrimit rinovohen në përfundim të afatit të vlefshërisë. Mjafton çertifikata e vjetër dhe një fotografi për të bërë shtyrjen e vlefshmërisë së çertifikatës , bazuar kjo në nenin 10, pika 3 të statutit.

## **Neni 7**

### **Karta e Anëtarësimit**

Karta e Anëtarësisë është mjet identifikimi për farmacistin dhe ndihmësfarmacistin ndaj pacientit dhe është e detyrueshme të mbahet në bluzën e bardhë gjatë kohës së punës.

## **Neni 8**

### **Regjistri manual dhe elektronik**

1. Pranë Aparatit Qendror Ekzekutiv të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë egzistojnë 2 regjistra; regjistri manual dhe regjistri elektronik.

2. Regjistri i farmacistëve është dokumenti bazë i evidentimit sasior dhe cilësor të farmacistëve në Republikën e Shqipërisë.

Regjistri vë në dukje jo vetëm rritjen numerike dhe levizjen e farmacistëve por edhe ecurinë e formimit dhe edukimit profesional e shkencor të farmacistëve në vite.

Regjistri i farmacistëve merr rol të rëndësishëm në evidentimin dhe rivlerësimin e standardeve profesionale të farmacistëve si dhe riçertifikimin ose jo të tyre për ushtrimin e profesionit.

3. Pasi farmacistët anëtarësohen në regjistrin e farmacistëve, këto informacione hidhen në programin informatik, i cili i ruan në një mënyrë edhe më të plotë informacionet mbi secilin anëtar, ndryshimet në vendin e tij të punës, kualifikimet dhe ndëshkimet e ndryshme profesionale që anëtari merr gjatë një harku kohor.

4. Nëpërmjet këtij programi bëhet e mundur nxjerrja e shumë raporteve të ndryshme si në shkallë vendi ashtu dhe në shkallë rajoni.

5. Dosja e plotë e secilit anëtar vendoset në një dosje më vete me numrin përkatës dhe ruhet në kartotekë pranë zyrave qendrore.

## **Neni 9 Konfidencialiteti**

1. Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë merr përsipër respektimin e konfidencialitetit të të dhënave personale të farmacistëve dhe ndihmës farmacistëve.

2. Mund të publikohen apo t'u ofrohen institucioneve të tjera vetëm këto të dhëna: emri i farmacistit, adresa e punës, specialiteti, specializimet e kryera, vlerësime dhe ndëshkime. Këshillat Rajonale nuk mund të ofrojnë të dhëna të tjera pa miratim të Këshillit Kombëtar.

## **Neni 10 Dokumentat standartë**

1. Procesi i regjistrimit përmban disa formularë standart:

**Formulari Nr. 1,** Dokumentacioni i nevojshëm për anëtarësim në urdhrin e Farmarmacistve

**Formulari Nr. 2,** Dokumentacioni i nevojshëm në rast ndryshimi të vendit të punës

**Kërkesë për anëtarësim dhe kërkesë për regjistrim**

**Vetëdeklarim për farmacistë dhe ndihmës farmacistë**

**Formulari i deklarimit të ndryshimeve**

**Shkresë përcjellëse**

2. Farmacistët publik e privatë janë të detyruar të sjellin për tu pasqyruar në këto formularë të gjitha ndryshimet e reja të ndodhura gjatë veprimtarisë së tyre profesionale. Këto të dhëna sillen nga ata sa herë që

kanë për të shtuar diçka në kurrikulën e tyre profesionale si dhe periodikisht kur t'iu kërkohen për akreditim dhe rivlerësim të standardeve profesionale. Shtesat në formularin e deklaramit të ndryshimeve shoqërohen me fotokopje të dokumentave që vërtetojnë ndryshimet e bëra. Farmacisti mban përgjegjësi për vërtetësinë e të dhënave që sjell.

### **Neni 11**

#### **Administrimi dhe përditësimi i Regjistrit dhe dosjes personale të farmacistit**

1. Dosja Personale e farmacistit dhe ndihmësfarmacistit, përmban të gjithë dokumentat rreth tij. Dosjes i vihet numri përkates i regjistrit dhe ruhet në kartotekën e zyrës qendrore. Dosjet e farmacistëve që fshihen nga regjistri (çregjistrohen) ruhen në kartotekë në ndarje të posaçme si dhe bëhet shënimi përkates në programin elektronik.
2. Farmacisti i anëtarësuar dhe ndihmësfarmacisti i regjistruar, pajisen me kartën e anëtarësisë, e cila mban numrin e dosjes personale që i korespondon numrit të regjistrit.
3. Formularët e Regjistrimit dhe të Ndryshimeve hidhen në sistemin elektronik dhe në mënyrë periodike përditësohen me të dhënat e reja profesionale si kualifikime, specializime, vleresime, ndeshkime dhe të dhëna të tjera të rivlerësimit periodik profesional.
4. Formularët e Regjistrimit të anëtarësimeve të reja si dhe ndryshimeve me të dhënat e përditësimit dhe rivlerësimit periodik në fund të çdo 3 mujori futen në sistemin e kompiuterizuar të Regjistrit Themeltar Kombëtar.

### **Neni 12**

#### **Administrimi i Regjistrit dhe dokumentave të farmacistëve në Aparatin Qendror Ekzekutiv të Këshillit Kombëtar**

1. Aparati Ekzekutiv i Këshillit Kombëtar kryen përditësimin periodik të Regjistrit Kombëtar me të dhënat që dërgohen nga Këshillat Rajonale.
2. Regjistri Kombëtar ruhet në formen e Dosjeve Manuale, të përbëra nga formularët e të dhënave të çdo anëtari, si edhe ne Formen e Kompjuterizuar (Database) pranë sektorit të Regjistrimit. Farmacistët e regjistruar në regjistrin Kombëtar do të kenë numrin e tyre në database.
3. Sektori i anëtarësimit dhe regjistrimit pranë Aparatit Qendror Ekzekutiv të Këshillit Kombëtar kryen edhe:
  - Monitorimin e procesit të regjistrimit dhe ruajtjes së Regjistrit
  - Verifikimin për kompletimin brenda afateve kohore të mungesave të dosjeve

- Dorëzimin dhe monitorimin e hedhjes së të dhënave të formularëve në Regjistrin Kombëtar
- Raportimin në mënyrë periodike, 6 mujore dhe vjetore në Bordin Drejtues mbi Regjistrin Kombëtar ku detajohen ndryshimet, të dhënat statistikore dhe informacione të tjera problemore në lidhje me regjistrimin
- Takimin me instanca të tjera publike për të verifikuar dhe kontrolluar të dhënat profesionale të farmacistëve
- Çertifikimin për ushtrimin e profesionit në sektorin privat si dhe lëshimin e dokumentave të tjera që kërkohen nga farmacistët anëtarë të Urdhrit.

## **DISPOZITA TE FUNDIT**

### **Neni 13**

#### **Ankimi për refuzimin e anëtarësimit dhe regjistrimit**

Ndaj vendimit që refuzon kërkesën për anëtarësim dhe regjistrim në Urdhrin e Farmacistëve, kërkuesi ka të drejtë të ankohet pranë Këshillit Kombëtar në përputhje me dispozitat që përcaktohen në nenin 15 të Statutit të Urdhrit të Farmacistëve.

### **Neni 14**

#### **Ndërprerja e anëtarësimit (Çregjistrimi)**

1. Për ndërprerjen e anëtarësimit në Urdhrin e Farmacistëve, zbatohen dispozitat e nenit 18 të Statutit të Urdhrit të Farmacistëve.
2. Dokumentat e çregjistrimit për farmacistët të cilëve i hiqet e drejta e ushtrimit të profesionit janë; Çertifikata e Anëtarësimit dhe kopja e vendimit disiplinor të formës së prerë nga organet e Urdhrit apo gjykatës. Dokumentat e çregjistrimit për farmacistët të cilët ndahen nga jeta, është vërtetimi nga Presidenti i këshillit rajonal përkatës.
3. Për farmacistet në pension dhe ato invalidë zbatohen dispozitat e nenit 16 të Statutit.

0

### **Neni 15**

#### **Çrregjistrimi i ndihmës farmacistëve**

Të gjithë ato ndihmës farmacistët, të cilët janë të regjistruar në regjistrin e posaçëm të ndihmësfarmacistëve, pas mbarimit të studimeve të larta dhe kryerjes me sukses të provimit të shtetit, në momentin e paraqitjes së dokumentave për anëtarësim, krahas dokumentave të kërkuara në

formularin Nr.1, duhet të dorëzojnë gjithashtu Çertifikatën e Regjistrimit dhe kartën e anëtarësimt, me qëllim që të bëhet çrregjistrimi i tij nga regjistri i posaçëm i ndihmësfarmacistëve.

**Neni 16**  
**Njoftimi për anëtarët**

Çdo Këshill rajonal brenda juridiksionit të vet ka përgjegjësinë për t'i njohur anëtarët e tij me përmbajtjen e kësaj Rregulloreje.

Bashkelidhur kësaj rregulloreje gjenden:

---

**Formulari Nr. 1**

**Formulari Nr. 2**

**Kërkesë për anëtarësim dhe kërkesë për regjistrim**

**Vetëdeklarim për farmacistë dhe ndihmës farmacistë**

**Formulari i deklarimit te ndryshimeve**

**Shkresë përcjellëse**

---



### ***Formular nr.1***

## **DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR ANËTARËSIM NË URDHRIN E FARMACISTËVE**

Çdo farmacist ose ndihmës farmacist që kërkon të regjistrohet në Urdhrin e Farmacistëve të Shqipërisë (UFSH) duhet të paraqitet personalisht në Këshillin Rajonal përkatës ose pranë zyrës së UFSH- së me dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë për anëtarësim në Urdhrin e Farmacistëve të Shqipërisë<sup>(1)</sup>
2. Vetëdeklarim<sup>(1)</sup>
3. Fotokopje e Diplomës dhe listës së notave e noterizuar ose e nënshkruar dhe vulosur nga presidenti i KR përkatës pas vërtetimit nga origjinali.
4. Kontratë me punëdhënësin (nëse është i/e punësuar)
5. Fotokopje e licencës së QKL
6. Fotokopje e ekstraktit të QKR
7. Fotokopje e Çertifikatës së Urdhrit të drejtuesit teknik.
8. Tre fotografi 3 x 3.5 cm.



9. Mandat pagesën <sup>(2)</sup> për :

- a) Tarifën e regjistrimit dhe kartën e anëtarësimit 1500 lekë
- b) Çertifikatën e Anëtarësimit 5000 lekë

<sup>(1)</sup> Formatet tip të këtyre dokumentave gjenden pranë zyrës së UFSH-së ose në faqen e internetit ufsh.org.al.

<sup>(2)</sup> Detyrimet financiare shlyhen në numrin e llogarisë 401069623 pranë Bankës Kombëtare Tregtare(BKT), në numrin e llogarisë 0100805804 pranë Bankës Raiffeisen ose në numrin e llogarisë 338610 pranë Bankës Credins.

**DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR REGJISTRIM  
NË URDHRIN E FARMACISTËVE**

1. Kërkesë për regjistrim në Urdhrin e Farmacistëve të Shqipërisë<sup>(1)</sup>
2. Vetëdeklarim për ndihmësfarmacist<sup>(1)</sup>
3. Fotokopje e Dëftesës së shkollës së mesme profesionale, e noterizuar ose e nënshkruar dhe vulosur nga presidenti i KR përkatës pas vërtetimit nga origjinali.
4. Kontratë me punëdhënësin (nëse është i/e punësuar)
5. Fotokopje e ekstraktit të QKR
6. Tre fotografi 3 x 3.5 cm.
7. Mandat pagesën <sup>(2)</sup> për :
  - a) Tarifën e regjistrimit dhe kartën e anëtarësimit 1500 lekë
  - b) Çertifikatën e Regjistrimit 5000 lekë

<sup>1)</sup> Formatet tip të këtyre dokumentave gjenden pranë zyrës së UFSH-së ose në faqen e internetit ufsh.org.al.

<sup>2)</sup> Detyrimet financiare shlyhen në numrin e llogarisë 401069623 pranë Bankës Kombëtare Tregtare(BKT), në numrin e llogarisë 0100805804 pranë Bankës Raiffeisen ose në numrin e llogarisë 338610 pranë Bankës Credins.



### ***Formular nr.2***

## **DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM NË RAST NDRYSHIMI TË VENDIT TË PUNËS**

- I) Dokumentet e kërkuara për ndryshimin e vendit të punës, nga i punësuar në drejtues teknik**
- a) Çertifikata e Anëtarësimit (origjinale)
  - b) Fotokopje e Librezës së punës dhe Librezës së kontributeve të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore (Për të vërtetuar periudhën 2 vjeçare të eksperiencës në punë)
  - c) Formulari i deklarimit të ndryshimeve \*
  - d) Kontratë pune me punëdhënësin (nëse është i/e punësuar)
  - e) 1 (një) fotografi
  - f) Fotokopje e Ekstraktit të lëshuar nga QKR
  - g) Fotokopje e liçencës të lëshuar nga QKL
  - h) Deklaratë e largimit të drejtuesit teknik të mëparshëm në qoftë se subjekti është ekzistues.

**II) Dokumentet e kërkuara për ndryshimin e vendit të punës të farmacistit drejtues teknik**

- a) Çertifikata e Anëtarësimit (origjinale)
- b) Formulari i deklarimit të ndryshimeve \*
- c) Kontratë pune me punëdhënësin (nëse është i/e punësuar)
- d) 1 (një) fotografi
- e) Deklaratë e largimit të drejtuesit teknik të mëparshëm në qoftë se subjekti është ekzistues.
- f) Fotokopje e Ekstraktit të lëshuar nga QKR
- g) Fotokopje e liçencës të lëshuar nga QKL

**III) Dokumentet e kërkuara për ndryshimin e vendit të punës për farmacistin i/e punësuar**

- a) Çertifikata e Anëtarësimit (origjinale)
- b) Formulari i deklarimit të ndryshimeve \*
- c) Kontratë pune me punëdhënësin
- d) Fotokopje e Çertifikatës së Anëtarësisë së drejtuesit teknik.
- e) 1 (një) fotografi

\*Formati tip gjendet pranë zyrës së UFSH-së ose në faqen e internetit [www.ufsh.org.al](http://www.ufsh.org.al)

Pika g, kërkohet të zbatohet vetëm pas përfundimit të procesit të liçensimit të Subjektit Farmaceutik.



## URDHRI I FARMACISTËVE TË SHQIPËRISË

### KËRKESE

Unë i/e nënshkruari/a \_\_\_\_\_, pasi u njoha me Kodin Deontologjik, Statutin dhe Rregulloret e Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë, Betimin e Hipokratit sipas formulimit të Gjenevës të vitit 1948, si dhe të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë Shërbimin Farmaceutik në Republikën e Shqipërisë, kërktoj të regjistrohem si anëtar i Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë, duke u zotuar për zbatimin e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga ky anëtarësim.

Kërkuesi/ja

\_\_\_\_\_, më \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
( Emri, mbiemri, firma)



## URDHRI I FARMACISTEVË TË SHQIPËRISË

### VETËDEKLARIM FARMACISTI / E

Unë, i/e nënshkruari/a \_\_\_\_\_, i/e datëlindjes \_\_\_\_\_, lindur në \_\_\_\_\_, me adresë pune në \_\_\_\_\_, nr. tel. \_\_\_\_\_, deklaroj nën përgjegjësinë time si më poshtë:

1. Jam diplomuar në Universitetin \_\_\_\_\_, me diplomë nr. \_\_\_\_\_ dt. \_\_\_\_\_, me notën mesatare \_\_\_\_ (\_\_\_\_\_).
2. Jam licensuar për herë të parë në vitin \_\_\_\_\_ me nr. licence \_\_\_\_\_ lëshuar nga \_\_\_\_\_.
3. Jam drejtues/e teknik në :  
Farmaci \_\_\_\_\_  
Importues, eksportues dhe shpërndarës farmaceutik \_\_\_\_\_  
Shpërndarës farmaceutik \_\_\_\_\_  
Jam i/e punësuar në :  
Farmaci \_\_\_\_\_  
Importues, eksportues dhe shpërndarës farmaceutik \_\_\_\_\_  
Shpërndarës farmaceutik \_\_\_\_\_  
Përfaqësi farmaceutike \_\_\_\_\_  
Jam i/e punësuar në institucionin shtetëror, publik, në pozicionin përkatës:  
Ministria e Shëndetësisë, \_\_\_\_\_  
Urdhri i Farmacistëve \_\_\_\_\_  
ISKSH \_\_\_\_\_  
QKKB \_\_\_\_\_  
DRSKSH \_\_\_\_\_  
Spitali \_\_\_\_\_
4. Do të zbatoj me përpikmëri Kodin Deontologjik, Statutin dhe Rregulloret e Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë, të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë Shërbimin Farmaceutik në Republikën e Shqipërisë.
5. Do të shlyej rregullisht dhe brenda afatit, pagesën e kuotës së anëtarësimit dhe të gjitha detyrimet e tjera, që parashikohen nga Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë.

6. Zotohem se profesionin e farmacistit do ta ushtroj me ndërgjegje dhe dinjitet në mbrojtje të shëndetit të pacientit.
7. Deklaroj se për çdo ndryshim që ka lidhje me pohimet e mësipërme, do të njoftoj Këshillin Rajonal të UFSH-së, për të kryer ndryshimet përkatëse.

Data \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ ( Emri, mbiemri, firma)



## URDHRI I FARMACISTËVE TË SHQIPËRISË

### VETËDEKLARIM NDIHMËS FARMACISTI / E

Unë, i/e nënshkruari/a \_\_\_\_\_, i/e datëlindjes \_\_\_\_\_, lindur në \_\_\_\_\_ dhe me adresë pune \_\_\_\_\_, nr. tel. \_\_\_\_\_, deklaroj nën përgjegjësinë time si më poshtë:

1. Jam diplomuar ndihmës farmacist/e në shkollën e mesme profesionale \_\_\_\_\_, me diplomë / dëftesë pjekurie nr. \_\_\_\_\_ dt. \_\_\_\_\_ dhe notë mesatare \_\_\_\_\_, ( \_\_\_\_\_ )
2. Jam licencuar për herë të parë në vitin \_\_\_\_\_ me licencë nr. \_\_\_\_\_ lëshuar nga \_\_\_\_\_.
3. Jam drejtues/e teknik/e në :  
Agjenci farmaceutike \_\_\_\_\_

Jam i/e punësuar në :

Farmaci \_\_\_\_\_  
Agjenci farmaceutke \_\_\_\_\_  
Importues, eksportues dhe shpërndarës farmaceutik \_\_\_\_\_  
Shpërndarës farmaceutik \_\_\_\_\_  
Spitali \_\_\_\_\_

4. Do të zbatoj me përpikmëri Kodin Deontologjik, Statutin dhe Rregulloret e Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë, të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë Shërbimin Farmaceutik në Republikën e Shqipërisë.
5. Do të shlyej rregullisht dhe në brenda afatit pagesën e kuotës së anëtarësimit dhe të gjitha detyrimet e tjera, që parashikohen nga Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë.

6. Zotohem se profesionin e ndihmës farmacistit/es do ta ushtroj me ndërgjegje dhe dinjitet në mbrojtje të shëndetit të pacientit.
7. Deklaroj se për çdo ndryshim që ka lidhje me pohimet e mësipërme, do të njoftoj Këshillin Rajonal të UFSH-së, për të kryer ndryshimet përkatëse.

Datë \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ (Emri, mbiemri, firma)



### FORMULARI I DEKLARIMIT TE NDRYSHIMEVE

Sot më datë \_\_\_\_, \_\_\_\_, \_\_\_\_, pranë zyrave të UFSH, unë i /e nënshkruar i/a \_\_\_\_\_, me Çertifikate Anëtarësie Nr. \_\_\_\_\_, Datë \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se;

**Më datë \_\_\_\_\_ kam shkëputur marrëdhëniet e punës si:**

1. Drejtues/e teknik/e në :  
Farmaci / Farmaci Spitalore / Importues, Eksportues dhe Shpërndarës  
Farmaceutik etj \_\_\_\_\_, me adresë \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_, nr telefoni \_\_\_\_\_.
2. I/e punësuar në :  
Farmaci / Farmaci Spitalore / Importues, Eksportues dhe Shpërndarës  
Farmaceutik / Përfaqësi Farmaceutike etj \_\_\_\_\_,  
Me adresë \_\_\_\_\_, nr telefoni \_\_\_\_\_.
3. I/e punësuar në Institucionin Shtetëror, Publik, në pozicionin përkatës:  
Ministria e Shëndetësisë / Urdhri i Farmacistëve / ISKSH / QKKB/DRSKSH etj \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_, me adresë \_\_\_\_\_,  
nr telefoni \_\_\_\_\_.

**Më datë \_\_\_\_\_ kam lidhur marrëdhëniet e punës si:**

1. Drejtues/e teknik në :  
Farmaci / Farmaci Spitalore / Importues, Eksportues dhe Shpërndarës  
Farmaceutik etj \_\_\_\_\_, me adresë \_\_\_\_\_,  
nr telefoni \_\_\_\_\_.
2. I/e punësuar në :  
Farmaci / Farmaci Spitalore / Importues, Eksportues dhe Shpërndarës  
Farmaceutik / Përfaqësi Farmaceutike etj \_\_\_\_\_, me adresë \_\_\_\_\_,  
nr telefoni \_\_\_\_\_.
3. I/e punësuar në Institucionin Shtetëror, Publik, në pozicionin përkatës:  
Ministria e Shëndetësisë / Urdhri i Farmacistëve / ISKSH / QKKB / DRSKSH etj \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_, me adresë \_\_\_\_\_,  
nr telefoni \_\_\_\_\_.

**Ndryshoj emrin e subjektit ku ushtroj profesionin: Po , Jo**

Nga \_\_\_\_\_, në \_\_\_\_\_.

**Ndryshoj logon në Çertifikatën e Anëtarësisë, Po , Jo**

**Ndryshoj të dhënat e mia personale:**

Nga (emri / mbiemri) \_\_\_\_\_  
Në (emri / mbiemri) \_\_\_\_\_

**Subjekti farmaceutik në të cilin do të ushtroj profesionin është:**

**-Ekzistues?**

**Po , Jo**

Nëse po, cili është drejtuesi/e teknik/e ekzistues?

(emri/mbiemri) \_\_\_\_\_ me Çertifikatë Anëtarësie Nr. \_\_\_\_\_, Datë \_\_\_\_\_

**-I hapur rishtazi?**

**Po , Jo**

Nëse po, cili është pozicioni Juaj në këtë Subjekt Farmaceutik si?

Drejtues/e teknik/e pronar/e subjektit **Po , Jo**

Drejtues/e teknik/e me kontratë pune me punëdhënësin

**Po , Jo**

***Shënim: Për çdo deklaram të pasaktë apo të rremë, nga ana e deklaruesit, të evidentuar nga Zyrat e Urdhrit, deklaruesi do të nënshtrohet gjykimin disiplinor profesional sipas akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse.***

Data \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
**(Emri, mbiemri, firma)**

**Konfirmim nga Zyra e Financës**

\_\_\_\_\_



**URDHRI I FARMACISTEVE**  
**Keshilli Rajonal \_\_\_\_\_**

Nr. Prot. \_\_\_\_\_

Datë \_\_\_\_\_

**SHKRESE PERCJELLESE**

Vërtetoj se Z/ Znj. \_\_\_\_\_ u paraqit personalisht pranë meje, për identitetin e të cilit/ cilës u sigurova nga dokumenti I tij identifikues, I cili/ cila kërkon të bëjë ndryshime në regjistrimin e tij të Urdhrit të Farmacistëve ose të regjistrohet për herë të parë në Urdhrin e Farmacistëve.

Për ndryshimet që ai/ajo kërkon të bëjë, paraqiti dokumentat bashkëngjitur kësaj shkrese përcjellëse, duke u bazuar në Formularin nr. 1 dhe Formularin nr. 2.

Dokumentat që personi paraqet shënohen më poshtë me shenjën X në kuadratin përkatës:

1. Kërkesë për anëtarësim në Urdhrin e Farmacistëve të Shqipërisë
2. Vetëdeklarim
3. Fotokopje e Diplomës dhe listës së notave e noterizuar ose e nënshkruar dhe e vulosur nga presidenti i KR përkatës (në pjesën e mbrapme)
4. Kontratë pune me punëdhënësin (nëse është i/e punësuar)
5. Fotokopje e licencës së QKL
6. Fotokopje e ekstraktit të QKR
7. Fotokopje e Çertifikatës së Urdhrit të drejtuesit teknik
8. Fotografi 3 x 3.5 cm
9. Mandat pagesa
10. Çertifikata e Anëtarësimit (origjinale)
11. Fotokopje e Librezës së punës dhe Librezës së kontributeve të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore (Për të vërtetuar periudhën 2 vjeçare të eksperiencës në punë)
12. Formulari i deklarimit të ndryshimeve
13. Deklaratë e largimit të drejtuesit teknik të mëparshëm (n.q.s subjekti është ekzistues)

**Presidenti i Këshillit Rajonal**

---